



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dërguar Priljezo / Prilato Received / Delivered	14. 07	702	2 viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinita Org / Unit	SKAMSHCK	4136/2022	1/1
Hi Prot Hi Prot Prot No		Shtopa Protog Appendix	Baza Kolicina Quantity



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 50/2022
Datë: 14/07/2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, nenit 7 paragrafit 1 nën paragrafi 1.6, nenit 20 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 6 paragrafi 1, 2, 4 dhe 5, nenit 14 paragrafi 1 të Rregullore Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave të Legjislacionit për Shërbimin Civil, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mbledhjen e dhjetë (10) të mbajtur më datë 14.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- 1. Aprovohet** Raporti i Monitorit të Jashtëzakonshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.
- 2. Obligohet** Kryeministri i Republikës së Kosovës, dhe Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e tij, sipas rekomandimeve të dhëna në raport.
- 3. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.
- 4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.**

Jeton KOCA
Kryetar i KPMShCK-së

Vendimi i dërgohet

- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimar / Doretuar Pranjenos/Prodato Received/Delivered	14.07.2022	2	viti god year
Organ /Bjësia Organ /Jedinita Org./Unit	Nr. Prot Bil. Prot Prot. No.	Shtetpi Protig Expenses	Sasia Kohëzina Quantity
SKINSHICK	4136/2022		119

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MONITORIMIT TË
JASHTËZAKONSHËM

në

MINISTRINË E FINANCAVE PUNËS DHE TRANSFEREVE

Prishtinë, 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i Monitorimit	4
Fusha e Monitorimit të Jashtëzakonshëm	5
Qëndrimi i Këshillit lidhur me shfuqizimin e dispozitave të ligjeve të veçanta përmes Ligjit Nr.06/l-114 Për zyrtarët publikë.....	6
Raport për Monitorimin e Jashtëzakonshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	7
Propozimi dhe Emërimi i Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës	8
Shpallja e Konkursit për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.....	9

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tutje referuar si Këshilli*) është institucion i themeluar me Kushtetutë, me mandat specifik për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Këshilli, mandatin e tij kushtetues, *sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil* e realizon përmes funksioneve themelore të përcaktuara me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si:

- *shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;*
- *monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.*

Këshilli, funksionet dhe përgjegjësitë themelore i ushtron në pajtim me:

- *Kushtetutën e Republikës së Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë;*
- *Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;*
- *Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;*
- *Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil;*
- *Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

FUNKSIONI I MONITORIMIT

Krahas funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes se ankesave të nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil, Këshilli ushtron edhe funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civile.

Ketë funksion e ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Këshilli, përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civile me qëllim të krijimit të një administratë publike, profesionale dhe efikase, sipas standardeve me të mira evropiane.

Funksioni i monitorimit ushtrohet përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil.

FUSHA E MONITIRIMIT TË JASHTËZAKONSHËM

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.05.2022 ka mbajtur mbledhjen e rregullt në të cilën mbledhje është miratuar kërkesa për monitorim të jashtëzakonshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), lidhur me procedurën e shpalljes së konkursit për pozitën e punës “Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës” dhe “Propozim-Emërimin e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës”. Rrjedhimisht në mbledhjen e datës 26.05.2022 me Vendimin me Nr.49/2022 është emëruar Kolegji për zhvillimin e procedurës së monitorimit të jashtëzakonshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Kolegji i Këshillit, më datë 09.06.2022 ka realizuar vizitën e monitorimit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ku është pritur nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Menaxheri i Burimeve Njerëzore.

Lidhur me çështje e Emërimit të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, të pranishmit deklaruan se nuk ka pasur të shpallur konkurs dhe se në këtë rast kanë vepruar në pajtim me praktikën e mëhershme, ndërsa lidhur me shpalljen e konkursit për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë deklaroi se për shkak të paqartësive ligjore apo kolizionit të ligjit lidhur me zbatimin e dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik apo atyre të Ligjit për Administratën Tatimore të Kosovës, me qëllim të rekrutimit të pozitave udhëheqëse të institucionit, janë shterur të gjithë hapat e konsullatave paraprake dhe analizimit të dispozitave ligjore me rastin e emërimit të Drejtorit të Njesisë së Inteligjencës Financiare, pasi që në parim që të dy rastet janë të ngjashme në kuptim të kontestit të paraqitur, andaj në parim kemi vepruar njëjtë.

Me qëllim të shmangies së çdo paqartësie në kuptim të referencave, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, mori për obligim që në afatin kohore prej një (1) jave të përcjellë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, një shkresë sqaruese lidhur me qëndrim juridik që e arsyeton veprimin e ministrisë në fjalë lidhur me dy rastet, shpalljen e konkursit për pozitën e “Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës” dhe “Propozim-Emërimin e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës”, ndërsa shkresën me provat e bashkangjitura, Këshilli e ka pranuar me datës 24.06.2022 e cila është protokolluar me numër:3700/2022.

QËNDRIMI I KËSHILLIT LIDHUR ME SHFUQIZIMIN E DISPOZITAVE TË LIGJEVE TË VEÇANTA PËRMES LIGJIT NR.06/L-114 PËR ZYRTARËT PUBLIKË

Kolegji i Këshillit, ka analizuar Aktgjykimin në rastin Nr.KO203/19 me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe ka gjetur së Gjykata Kushtetuese në pikën 211 të aktgjykimit ka konstatuar se: (...) *Deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për aq sa nuk cenojnë pavarësinë funksionale dhe organizative të Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi.* Andaj, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit konstaton se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020, dhe i njëjti, me dispozitat e neni 32 paragrafi 3 ka përcaktuar, se: *Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji*, ndërsa neni 85 ka shfuqizuar Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Po ashtu, duke u bazuar në nenin 9 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 dhe nenin 22 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe nenin 2 paragrafin 3, dhe nenin 33 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit konstaton se pozita e *Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës*, si dhe pozita e *Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës* hynë në kategorinë e pozitave të nivelit të lartë drejtues në kuadër të Shërbimit Civil, dhe si të tilla i nënshtrohen regjimit juridik të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Rrjedhimisht, me dispozitat e nenit 40, 41 dhe 42 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rregullohet procedura dhe mënyra e emërimit të nëpunësve civil në pozitat e kategorisë së lartë drejtuese.

Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin në rastin nr.KO203/19 të datës 09.07.2020, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ka vendosur lidhur me komentet e Policisë së Kosovës, të cilat për nga natyra juridike janë të ngjashme me qëndrimet juridike të parashtruara në shkresën e datës 23.06.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Gjykata ka sqaruar se Ligji i kontestuar sipas nenit 85 të tij në mënyrë të qartë shfuqizon Ligjin për Shërbimin Civil si dhe çdo dispozitë tjetër juridike, që është në kundërshtim me të, duke përfshirë edhe ligjet e veçanta. Ndërsa lidhur me pretendimin e Policisë së Kosovës se Ligji i kontestuar cenon parimin e sigurisë juridike pasi nuk shfuqizon në mënyrë specifike Ligjin për Policinë e Kosovës lidhur me dispozitat që rregullojnë marrëdhënien e punës së stafit administrativ, Gjykata i referohet rastit të Gjykatës KO97/12, Parashtrues: Avokati i Popullit, Aktgjykim i 13 marsit 2013, ku kishte konstatuar se parimi i sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit kërkon që një ligj i ri nuk mund të anulohet dispozitat e një ligji ekzistues pa ndryshuar dispozitat relevante (shih rastin KO97/12, paragrafi 128). Gjykata në këtë rast kishte ardhur në përfundim se Ligji Nr.04/L-093 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo-bankare, kishte dispozita që nuk ishin në pajtueshmëri me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ por ky Ligj në nenin 117 [Efekti në dispozitat e mëparshme statutores] përcaktonte se ky Ligj shfuqizon vetëm Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/21.

Gjykata ka vlerësuar se rrethanat e këtij rasti dallojnë nga rrethanat e Ligjit të kontestuar pasi, Ligji i kontestuar në nenin 85 në mënyrë të qartë shfuqizon Ligjin për Shërbimin Civil dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me të duke rregulluar marrëdhënien e punës për të gjithë zyrtarët publikë me përjashtim të atyre të përcaktuar në nenin 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pretendimi i Policisë së Kosovës lidhur me shkeljen e parimit të sigurisë juridike në kundërshtim me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO97/12, nuk është i bazuar (*shih* Aktgjykimin në rastin nr.KO203/19 të datës 09.07.2020, paragrafi 192-198).

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji i Këshillit vlerëson se me nenin 85 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, janë shfuqizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, me të cilat është përcaktuar procedura dhe mënyra e emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovës, me të cilat është përcaktuar procedura dhe mënyra e emërimit të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, sepse këto dispozita janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka rregulluar marrëdhënien e punës për të gjithë zyrtarët publikë, me përjashtim të atyre të përcaktuar në nenin 3 dhe 4 të këtij Ligji.

RAPORT PËR MONITORIMIN E JASHTËZAKONSHËM NË MINISTRINË E FINANCIVE PUNËS DHE TRANSFEREVE

Kolegji i Këshillit, gjatë procesit të monitorimit të jashtëzakonshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për të vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të paanshme ligjshmërinë e veprimeve të ndërmarra nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me shpalljen e konkursit për rekrutimin e pozitës së Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, dhe rrjedhimisht veprimet lidhur me emërimin e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, ka administruar këto prova:

E-mailin e datës 21.12.2021 të dërguar nga _____ për _____ E-mailin e datës 26.01.2022 të dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i MFPT-së për _____ me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (faqesh); E-mailin e datës 17.01.2022 të dërguar nga _____ për Sekretarin e MFPT-së; E-mailin e datës 17.01.2022 të dërguar nga _____ për _____ me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 23.02.2022 të dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i MFPT-së për _____ Shkresën e datës 23.06.2022 me numër 02/112 të pranuar në Këshill me datë 24.06.2022 dhe protokolluar me numër 3700/2022; Shkresën e datës 22.04.2022 për propozimin e pikës të rendit të ditës në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës; Deklaratën e pajtueshmërisë të datës 22.04.2022; Propozim vendimin e datës 23.05.2022; Regjistrin e Aplikacioneve të pranuar për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së"; Deklaratën nën betim të datës 09.06.2022; Vendimin me numër Nr.01/79 të datës 25.05.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Konkursin e shpallur për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së"; Vendimin me numër:49/2022 të datës 26.05.2022 të Kryetarit të Këshillit.

PROPOZIMI DHE EMËRIMI I KRYEINSPEKTORIT TË INSPEKTORATIT TË PUNËS

Kolegji i Këshillit në procesin e monitorimit të jashtëzakonshëm, duke ju referuar shkresave të lëndës ka gjetur:

E GJETUR: Gjatë shqyrtimit të shkresave të ofruara nga Njësia e Burimeve Njerëzore, është konstatuar se Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve përmes shkresës me numër protokoll 1096/2022 të datës 23.05.2022 dhe në dijeni të Ministrit të MFPT ka propozuar pikë të rendit të ditës për mbledhje të Qeverisë së Republikës së Kosovës, emërimin e *Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës* me deklaratën e bashkangjitur të papajtueshmërisë, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 25.05.2022 me Vendimin numër 01/79 ka emëruara Kryeinspektor të Inspektoratit të Punës, me mandat katër (4) vjeçar.

Sipas deklaratës të Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, emërimi i Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, nuk është bërë përmes zhvillimit të procedurave të konkursit.

KONSTATIM: Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në nenin 9 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 dhe nenin 22 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe nenin 2 paragrafin 3, dhe nenin 33 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se pozita e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, hynë në kategorinë e pozitave të nivelit të lartë drejtues në kuadër të Shërbimit Civil, dhe si e tillë i nënshtrohen regjimit juridik të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Andaj, Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin numër 01/79 të datës 25.05.2022 për emërimin e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, pa u zhvilluar procedurë e rekrutimit ka ra ndesh me dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe si rrjedhojë në rastin konkret janë shkelur rendë parimet e pranimit të zyrtarëve publikë të përcaktuara me nenin 6 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Rekomandim: Me qëllim të kthimit të ligjshmërisë rekomandojmë Kryeministrin e Republikës së Kosovës, që të ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për anulimin e Vendimit numër: 01/79 të datës 25.05.2022, siç përcaktohet me nenin 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

SHPALLJA E KONKURISIT PËR POZITËN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS

Kolegji i Këshillit në procesin e monitorimit të jashtëzakonshëm, duke ju referuar shkresave të lëndës ka gjetur:

E GJETUR: Gjatë shqyrtimit të shkresave të ofruara nga Njësia e Burimeve Njerëzore, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka shpallur Konkurs publikë me numër reference 01/2022/ATK/MFPT për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, ku afati për aplikim ka qenë 30 ditë dhe atë nga data 08.04.2022 deri me datë 10.05.2022. Sipas Formularit Form.MAP-SHCK-04 për regjistrin e aplikacioneve të pranuar, në këtë konkurs kanë aplikuar trembëdhjetë (13) kandidatë.

KONSTATIM: Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 9 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 dhe nenin 22 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe nenin 2 paragrafin 3, dhe nenin 33 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, hynë në kategorinë e pozitave të nivelit të lartë drejtues në kuadër të Shërbimit Civil, dhe si e tillë i nënshtrohen regjimit juridik të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. andaj Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me rastin e shpalljes së konkursit për pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës ka vepruar në kundërshtim me nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pasi që në kuptim të nenit 34 paragrafi 3, përgjegjëse për shpalljen e konkursit respektivisht organizmin e konkurrimit për organet e administratës shtetërore është Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP) i cili funksionon në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratën publike, respektivisht Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Rekomandim: Me qëllim të kthimit të ligjshmërisë rekomandojmë Ministrin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për anulimin e Konkursit me numër referencë 01/2022/ATK/MFPT për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, dhe po ashtu i njëjti të kujdeset që në të ardhmen shpallja e konkursit, përzgjedhja dhe emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës të bëhet në pajtim me konstatimet e dhëna në këtë raport.

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional


Flakron GASHI


Kryetare e Kolegjit
Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Raporti i dërgohet:

- Anëtarëve të KPMSHCK-së;
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK.

